



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Autoriteti Kombëtar Për Certifikimin Elektronik

UDHËZIM
PËR AFATET E PËRGJITHSHME



Udhëzim nr.3
Versioni 3.1
Buletini 2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK

UDHËZIM NR. 3

PËR AFATET E PËRGJITHSHME

Bazuar në Ligjin nr. 9880 datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar, Ligjin nr. 107/2015, datë 1.10.2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 69, datë 27.1.2016 “Për miratimin e rregullores për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik (në vazhdim Autoriteti),

UDHËZON:

Të gjithë personat fizikë ose juridikë, që duan të ushtrojnë aktivitetin si Ofrues i kualifikuar i Shërbimit të Besuar (OKSHB) ose të Organizmit të Testimit dhe Konfirmimit (OTK), duhet t’i përmbahen afateve të poshtëshënuara:

1. Autoriteti merr vendim dhe njofton subjektet të cilat kanë aplikuar për akreditim pranë tij, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e dorëzimit të aplikimit nga Ofruesi i Shërbimit të Besuar ose OTK.

Kur kërkohet plotësim dokumentacioni ose informacion shtesë gjatë fazës së regjistrimit, subjekti duhet të kryejë plotësimin e tyre brenda 20 (njëzet) ditëve nga marrja e njoftimit.

Nëse dokumentacioni i kërkuar nuk plotësohet brenda këtij afati, atëherë kërkesa e subjektit anulohet dhe procedura e regjistrimit duhet ribërë.

Autoriteti merr vendimin dhe njofton subjektin, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e dorëzimit të dokumentacionit shtesë.

2. Në çdo rast kur kërkohet informacion nga Autoriteti dhe në kërkesë nuk është paracaktuar afati/data, OKSHB duhet të kthejë përgjigje brenda 5 (pesë) ditësh nga dita e marrjes së kërkesës.

3. Në rast të transferimit të detyrave ose veprimtarisë së OKSHB tek personat e tretë, ky i fundit njofton Autoritetin jo më vonë se dita e fillimit të transferimit. Në njoftim pasqyrohen hollësisht edhe shkaqet dhe pasojat e këtij transferimi.

4. OKSHB krijon Arkivin e Certifikatave të Kualifikuara duke dokumentuar certifikatat e kualifikuara të lëshuara, në mënyrë të tillë që, të dhënat dhe saktësia e tyre të jenë të verifikueshme në çdo kohë.

Arkivi i Certifikatave të Kualifikuara, duhet të ruhet nga OKSHB për jo më pak se 20 (njëzet) vjet nga data e revokimit ose mbarimit të vlefshmërisë së certifikatës.

5. Në rast se, zotëruesi i kodeve të nënshkrimit kërkon të njihet me të dhënat dhe hapat proceduralë të lidhur me to, të cilat ruhen nga OKSHB, ky i fundit është i detyruar të kthejë përgjigje brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga momenti i dorëzimit të kërkesës.

6. Sa herë që ka ndryshime në sistem, të cilat kërkojnë verifikimin e ruajtjes së besueshmërisë pas ndryshimeve, OKSHB brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, është i detyruar të njoftojnë Autoritetin dhe OTK, duke depozituar pranë tyre çdo ndryshim në detajet/specifikimet teknike të sistemit.

OTK brenda një periudhe kohore prej 20 (njëzet) ditësh, kontrollon këto modifikime, kryen vlerësimet, konfirmon pajtueshmërinë teknike dhe ia dorëzon raportin Autoritetit. Në varësi të ndryshimeve dhe me kërkesë të argumentuar, ky afat mund të zgjatet.

7. Ofruesi i Shërbimit të Besuar që fillon aktivitetin duhet të dëshmojë se, plotëson kërkesat ligjore, teknike dhe financiare të përcaktuara në rregulloren “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”. Këto kërkesa duhet të plotësohen gjatë gjithë kohëzgjatjes së veprimtarisë si OKSHB.

8. Subjektet që kërkojnë të njihen si Organizëm Testimi dhe Konfirmimi, duhet të dorëzojnë një aplikim në Autoritet, me të cilin do të kërkojnë njohjen prej tij, duke dorëzuar në të njëjtën kohë gjithë dokumentacionin e listuar në rregulloren “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”. Do të aplikohen afatet e përcaktuara më lart. Aktiviteti i OTK duhet të rivlerësohet të paktën një herë çdo 2 (dy) vjet.

9. Konfliktet që mund të lindin midis OKSHB dhe OTK, zgjidhen me ndërhyrjen e Autoritetit ose/dhe në rrugë gjyqësore. Autoriteti merr vendim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga paraqitja e ankesës nga palët. Nëse palët nuk bien dakord me vendimin e Autoritetit, ato mund të bëjnë ankim në gjykatë për zgjidhjen e çështjes.

10. Afatet e përcaktuara në këtë udhëzim janë të llogaritura në ditë pune. Moszbatimi i afateve të përcaktuara me sipër, konstatimi i mospërbushjes së të gjitha llojeve të afateve të përcaktuara në ligj, rregullore dhe udhëzime ngarkon me përgjegjësi subjektet që duan të regjistrohen, janë të regjistruara, ose ato që duan të transferojnë apo ndërpresin aktivitetin.

11. Moszbatimi i afateve të pacaktuara në këtë Udhëzim nga OKSHB dhe OTK shoqërohet me masa administrative sipas parashikimeve të nenit 57 të Ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008 “Për Nënshkrimin Elektronik” dhe të nenit 37 të Ligjit nr. 107/2015, datë 1.10.2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”.

Tiranë, më 8.2.2016